

V E N D I M
Nr. 675, datë 20.12.2002

**PËR PËRDORIMIN E FONDEVE BUXHETORE TË PLANIFIKUARA PËR MALLRAT,
SHËRBIMET DHE NDËRTIMET**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr. 7971, datë 26.7.1995 “Për Prokurimin Publik” me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. Të përgjithshme

1.1 Vendimi të zbatohet për të gjitha fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit, të planifikuara për mallra, shërbime dhe ndërtime.

1.2 Vendimi të zbatohet nga të gjitha organet, institucionet qendrore dhe vendore dhe ato të varësisë, që në vijim do të quhen institucione, të cilat kanë fonde të planifikuara, për mallra, shërbime dhe ndërtime.

1.3 Institucionet, përveç rregullave të përcaktuara në këtë vendim do të zbatojnë ligjin “Për Prokurimin Publik”, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore, në zbatim të tij.

II. Regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike

2.1. Institucionet pas miratimit të buxhetit, në bazë të kërkesave dhe të fondeve të miratuara në buxhet, për mallra, shërbime dhe ndërtime, përgatisin dhe plotësojnë regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike, sipas formës dhe mënyrës së përcaktuar në udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

2.2. Një kopje e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike i miratuar nga titullari i institucionit, dërgohet brenda datës 20 janar të çdo viti, në Agjencinë e Prokurimit Publik.

2.3. Agjencia e Prokurimit Publik, në bazë të të dhënave të regjistrave të parashikimeve të prokurimeve, të dërguar nga institucionet, përgatit regjistrin qendror të parashikimit të prokurimeve publike dhe bën shpalljen e buletinit special vjetor të parashikimeve të prokurimeve publike.

2.4. Një kopje e regjistrit qendror të parashikimit të prokurimeve publike i dërgohet Ministrisë së Financave, për drejtorinë e thesarit dhe të buxhetit. Drejtoria e thesarit ua shpërndan jo më vonë se data 20 janar e çdo viti, degëve të thesarit.

III. Prokurimi i fondeve për mallra, shërbime dhe ndërtime

3.1. Procedurat e prokurimit për përmbushjen e nevojave vjetore për mallra, shërbime dhe ndërtime, të planifikuara e të ndara për secilën prej tyre, për çdo institucion, ent prokurues, kryhen në fillim të vitit buxhetor. Procedurat e prokurimit të përfundojnë brenda muajit maj të çdo viti, duke përfshirë në këtë afat edhe lidhjen e kontratave përkatëse.

3.2. Procedurat e prokurimit nga institucionet për përdorimin e fondeve për mallra, shërbime dhe ndërtime, të krijuara ose të shtuara pas miratimit të Buxhetit të Shtetit, nisin menjëherë pas vënies në dispozicion të këtyre fondeve. Institucionet, në këtë rast, njoftojnë Agjencinë e Prokurimit Publik, e cila bën ndryshimet përkatëse në Regjistrin Kombëtar të Prokurimeve Publike.

3.3. Procedurat e prokurimit të fondeve të planifikuara për ndërtime apo objektet, të cilat nuk kanë projekte të miratuara, nisin menjëherë pas përfundimit të projektit.

IV. Lidhja e kontratave

4.1. Kontratat për mallra, shërbime apo ndërtime, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në pikën 5 të nenit 17 të ligjit nr.7981 “ Për Prokurimin Publik” lidhen me afat, deri në mbylljen e vitit buxhetor.

4.2. Kontratat lidhen me kusht vlefshmërie dhe me afate të përcaktuara për përmbushjen e detyrimeve, në varësi të vënies në dispozicion të fondit përkatës dhe të ndarjes katërmujore të fondeve të planifikuara në buxhet.

4.3. Kontratat, pas kryerjes së procedurave të prokurimit, të përcaktuara në pikat 6.1, 6.2 dhe 6.3 të këtij vendimi, lidhet nga institucioni, në emër të të cilit është zhvilluar prokurimi, brenda fondit të vënë në dispozicion dhe sipas nevojave të parashikuara.

V. Regjistri i realizimit të prokurimeve

5.1. Organet dhe institucionet buxhetore përgatisin dhe plotësojnë regjistrin e realizimit të prokurimeve, sipas modelit dhe mënyrës së përcaktuar në udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

5.2. Një kopje e regjistrin të realizimit të prokurimeve e miratuar nga drejtuesi i institucionit, i dërgohet brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 3.1 të këtij vendimi, për përfundimin e prokurimeve, Agjencisë së Prokurimit Publik.

5.3. Agjencia e Prokurimit Publik, në bazë të të dhënave të regjistrave të realizimit të prokurimeve, të dërguar nga institucionet, përgatit regjistrin qendror të realizimit të prokurimeve publike dhe shpall buletin special, vjetor të parashikimeve të prokurimeve publike.

VI. Të veçanta

6.1. Për kryerjen e procedurave të prokurimit për të njëjtin mall, shërbim apo ndërtim, të parashikuar për institucionet, entet prokuruese të varësisë, ngarkohet institucioni epror, ent prokurues, ose njëri nga institucionet e autorizuar prej tij. Ky ent prokuron me fondin e llogaritur si shumë e fondeve të miratuara, për çdo institucion varësie, për të njëjtin mall, shërbim ose ndërtim. Brenda fondit të miratuar secili institucion lidh kontratën përkatëse me subjektin fitues të prokurimit.

6.2. Për plotësimin e nevojave të ministrive dhe të institucioneve e të organeve në varësi të tyre, për mallrat dhe shërbimet e poshtëshënuara, ngarkohen institucionet respektive, entet prokuruese, të poshtëshënuara të kryejnë procedurat e prokurimit në emër të tyre. Këto ente prokurorin me fondin e llogaritur si shumë e fondeve të miratuara për çdo institucion, për secilin nga mallrat dhe shërbimet e shënuara, konkretisht :

- për shërbimet për furnizim me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje qendrore ngarkohet Ministria e Industrisë dhe Energjetikës;

- për shërbimet për furnizim me karburant për fluturimet ajrore ngarkohet Ministria e Mbrojtjes;

- për shërbimet e komunikimit me telefoni celulare, internet dhe e-mail (abonimet e reja) ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit;

- për blerjet e autovecurave për zyrtarët e lartë të shtetit ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, sipas përcaktimeve teknike dhe standardeve të sigurisë, të përcaktuara nga Ministria e Rendit Publik;

- për blerjet për autovecurat të tjera ngarkohet Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit;

- për blerjet e kompjuterave, makinave të shumëfishimit dhe të pajisjeve të tjera të teknologjisë elektronike ngarkohet Ministria e Ekonomisë;

- për rikonstruksionin e godinave të ministrive ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit.

6.3. Agjencia e Prokurimit Publik, për zbatimin e pikave 6.1 dhe 6.2 ju dërgon institucioneve, ent prokurues, të ngarkuara për prokurimin e fondeve për llogari të të tretëve, të dhënat e regjistrin të parashikimeve të prokurimeve, duke përcaktuar llojin e mallit, fondet përkatëse, si dhe emrin e institucionit, në emër të të cilit bëhet prokurimi.

6.4. Jo më vonë se data 15 shkurt e çdo viti, institucionet, ent prokurues, mund të kërkojnë delegimin e kryerjes së prokurimit për llogari të tyre, një institucion tjetër, që propozohet nga Agjencia e Prokurimit Publik. Në këto raste, miratimi jepet nga Këshilli i Ministrave.

VII. Të fundit

7.1. Afatet e përcaktuara në pikat 2.2; 2.4; 3.1; 5.2 dhe 6.3 shtyhen, për vitin 2003, edhe për një periudhë 15-ditore.

7.2. Ngarkohet Agjencia e Prokurimit Publik të nxjerrë udhëzimet përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

7.3. Ngarkohen ministritë dhe institucionet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

